LIGJ
Nr. 99/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES DYPALËSHE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT RAJONAL NË SHQIPËRI (FAZA 4, 2019–2023)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja dypalëshe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për programin e zhvillimit rajonal në Shqipëri (Faza 4, 2019–2023), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11576, datë 3.8.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE DYPALËSHE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT RAJONAL NË SHQIPËRI
FAZA 4, 2019–2023

Me qëllim forcimin e marrëdhënieve miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve;

Në përputhje me dhe në zbatim të Marrëveshjes Kuadër lidhur me bashkëpunimin teknik, financiar dhe humanitar ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 11 maj 2007;

Respektimi i parimeve demokratike dhe i të drejtave themelore të njeriut – siç përcaktohet në mënyre të veçantë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut – frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të dy Palëve dhe përbën një element thelbësor në pozita të barabarta me objektivat e Marrëveshjes aktuale;

Në përpjekje për të arritur një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm, një ekonomi më konkurruese dhe përmirësim të cilësisë së jetesës së qytetarëve shqiptarë,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga zëvendëskryeministri, dhe Konfederata Zvicerane, e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, kanë rënë dakord për termat dhe kushtet e përcaktuar më poshtë.

Neni I
Përkufizime

Kudo të përdorura në këtë Marrëveshje, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat vijues kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. "Palët Kontraktuese" nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatën Zvicerane;
2. "Zyra" nënkupton Zyrën e Zëvendëskryeministrit;
3. "SDC" nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal të Punëve të Jashtme Zviceran, e cila përfaqësohet në Shqipëri nga Ambasada e Zvicrës;
4. Agjencia Ekzekutive i referohet Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC);
5. "Projekti" nënkupton Programin e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri, faza 4, e financuar nga SDC-ja dhe Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA);
6. "Agjencia e bashkëpunimit" i referohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH);
7. "Agjencia e bashkëfinancimit" i referohet Agjencisë Austriake të Zhvillimit (ADA);
8. "Partner Zbatues" nënkupton Ecorys, agjencia që është kontraktuar pas një tenderi të hapur ndërkombëtar nga një komitet i përbashkët vlerësimi i SDC-së, ADA dhe qeverisë së Shqipërisë e cila ka për detyrë zbatimin e Projektit.

Neni II
Qëllimet dhe objektivat

Qëllimi i përgjithshëm i projektit: Nxitja e një zhvillimi shoqëror dhe ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, duke u mbështetur në karakteristikat dhe atributet e rajoneve, duke ruajtur dhe zhvilluar karakteristikat e tyre natyrore dhe kulturore, duke inkurajuar potencialin e tyre të zhvillimit ekonomik, me qëllim uljen e pabarazive në Shqipëri dhe sigurimin e kushteve më të mira sociale dhe ekonomike për qytetarët shqiptarë. Projekti përshkruhet në detaje në përshkrimin e projektit bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje (shtojca 1).

Objektivat specifikë:

1. Mbështetja e orientimit të politikave qeveritare drejt një zhvillimi funksional rajonal, në përputhje me politikën rajonale të BE-së;
2. Hartimi dhe miratimi i një kornize strategjike dhe rregullatore që mundëson krijimin dhe funksionimin efikas të një sistemi të zhvillimit rajonal, në përputhje me politikat dhe praktikat e BE-së;
3. Ngritja e një sistemi institucional të zhvillimit rajonal, si një mekanizëm efikas drejt administrimit dhe zhvillimit në nivel rajonal për menaxhimin e fondeve strukturore të BE-së në të ardhmen;
4. Bërja e administratës funksionale financiare dhe e sistemit të administrimit të zhvillimit rajonal në nivelin qendror, rajonal dhe lokal, përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të skemave të granteve në kushte reale, duke ndikuar njëkohësisht në përmirësimin e jetës social-ekonomike të qytetarëve në Shqipëri.

Rezultatet e pritshme

Nëpërmjet realizimit të qëllimeve dhe të arritjes së objektivave të përmendur më lart, pritet të arrihen rezultatet e mëposhtme.

1. Zhvillimi i kuadrit ligjor – Ligji për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, si dhe aktet nënligjore.

2. Propozimi për krijimin e strukturave në nivelin qendror dhe rajonal, përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e Politikës për Zhvillimin Rajonal.

3. Mbështetje për FSHZH-në, si një autoritet menaxhues për zbatimin e programit:

a) operacional dhe institucione të tjera përgjegjëse për zhvillimin rajonal.

4. Përgatitja e një kuadri financiar shumëvjeçar për zhvillimin rajonal.

5. Ekspozimi ndërkombëtar i zhvillimit rajonal në Shqipëri.

6. Të mbështesë ngritjen e kapaciteteve rajonale dhe kombëtare për hartimin dhe për komunikimin e një strategjie të përshtatshme për zbatimin e zhvillimit rajonal në nivelin rajonal dhe lokal.

7. Zhvillimi i një mekanizmi të skemës së granteve që mbështet përmirësimin e kushteve socioekonomike të qytetarëve të Shqipërisë, duke reflektuar nevojat dhe përparësitë rajonale.

8. Forcimi i kapaciteteve për të zhvilluar projekte në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

9. Forcimi i kapaciteteve të menaxhimit të granteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

10. Vizibiliteti dhe komunikimi i skemave të granteve për zhvillimin rajonal në Shqipëri.

Neni III
Përgjegjësia e zbatimit

1. Zëvendëskryeministri do t'i besojë FSHZH-së përgjegjësinë për zbatimin teknik të Projektit "Programi për zhvillimin rajonal".

2. SDC-ja do të jetë Agjencia Ekzekutive për zbatimin e Marrëveshjes dhe të Projektit. SDC-ja do t'ia delegojë përgjegjësinë e zbatimit Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

3. ADA është një agjenci bashkëfinancuese e Projektit. ADA dhe SDC kanë rënë dakord në një Marrëveshje për Delegim të Bashkëpunimit, për t'i dhënë SDC-së pozicionin e donatorit kryesor të Projektit. SDC-ja do të administrojë kontributet (e SDC-së dhe të ADA-s) dhe do të ndjekë Projektin me qeverinë shqiptare dhe Partnerin Zbatues. Nëse ADA do të reduktojë ose anulojë kontributin e saj ose anulojë Marrëveshjen për Delegimin e Bashkëpunimit gjatë periudhës së kësaj Marrëveshjeje, kontributi i përgjithshëm do të reduktohet në përputhje me rrethanat.

Neni IV
Kontributi i Palëve

Nga pala shqiptare:

1. Këshilli i Ministrave vë në dispozicion të Projektit buxhetin e nevojshëm për të rimbursuar TVSH-në në shumën maksimale deri në 84,000 CHF (tetëdhjetë e katër mijë franga zvicerane). Fondi i mësipërm do të parashikohet si zë në buxhetin e FSHZH-së.

Nga pala zvicerane-austriake:

2. Kontributi kryhet në formën e një granti dhe përdoret për zbatimin e aktiviteteve të projektit, siç përcaktohet në përshkrimin e projektit (shtojca 1), i cili përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje. Ky grant nuk mund të livrohet për asnjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grantit të mbetur në fund të projektit i nënshtrohet rikthimit te SDC-ja.

3. Granti, për fazën 4, arrin në shumën e 7,725,000 CHF (shtatë milionë e shtatëqind e njëzet e pesë mijë franga zvicerane), nga të cilat 1,725,000 CHF (një milion e shtatëqind e njëzet e pesë mijë

franga zvicerane) janë kontribut i ADA-s dhe 6.000.000 CHF (gjashtë milion franga zvicerane) janë kontribut i SDC-së.

Neni V

Rolet dhe përgjegjësitë e Palëve

Rolet dhe përgjegjësitë e zëvendëskryeministrit do të ekzekutohen përmes Zyrës.

Zyra do të:

1. sigurojë që FSHZH-ja do të vërë në dispozicion livrimin e nevojshëm të buxhetit për të rimbursuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për Projektin. FSHZH-së duhet t'i paraqitet çdo vit konfirmimi i auditorit të jashtëm, kontraktuar nga projekti nën mandatin e SDC-së, lidhur me verifikimin e shpenzimeve për të cilat Partneri Zbatues ka paraqitur kërkesën për rimbursim të TVSH-së;

2. jetë bashkëpërgjegjëse për drejtimin dhe zbatimin e Projektit;

3. sigurojë zbatimin dhe përputhshmërinë e Projektit me programin politik të qeverisë shqiptare dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020;

4. marrë pjesë në Komitetin Drejtues të Projektit, duke monitoruar në mënyrë periodike performancën e projektit dhe duke kontribuar në zgjidhjen e problemeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit;

5. jetë përgjegjëse për koordinimin e aktiviteteve me qëllimin e arritjes së objektivave të projektit;

6. jetë përgjegjëse, së bashku me FSHZH-në, për koordinimin e aktiviteteve me qëllim të arritjes së objektivave, siç përshkruhet në nenin II të kësaj Marrëveshjeje, dhe pranimin e rezultateve të krijuara nga këta objektiva;

7. ndërmarrë, së bashku me FSHZH-në, të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të dakordësuara të Projektit;

8. sigurojë, së bashku me FSHZH-në, kapacitetet e nevojshme për të ndihmuar Partnerin Zbatues për pjesë të ndryshme të Projektit;

9. sigurojë, së bashku me FSHZH-në, akses në informacione të rëndësishme, përfshirë të dhëna statistikore, të cilat konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni do të përdoret vetëm për qëllimet e Projektit.

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim:

1. SDC-ja do të administrojë fondet e Projektit përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

2. SDC-ja do të sigurojë fonde nga granti i mësipërm për prokurimin dhe furnizimin e mallrave dhe të shërbimeve, në përputhje me aktivitetet e dakordësuara nga Palët.

3. SDC-ja do të sigurojë ekspertizën teknike në dispozicion të Zyrës dhe FSHZH-së, në mbështetje të Reformës së Zhvillimit Rajonal.

Neni VI

Mbikëqyrja dhe koordinimi

1. Për të siguruar mbikëqyrjen dhe koordinimin e përgjithshëm të Projektit, si dhe për të adresuar çështjet politike, do të themelohet një Komitet Drejtues i Projektit (KDP). KDP-ja do të ketë një kuorum vetëm kur përfaqësuesit e dy Palëve Kontraktuese të jenë të pranishëm dhe vendimet të merren me konsensus.

2. KDP-ja do të përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm me të drejtë vote:

a) 1 përfaqësues i Zyrës së Zëvendëskryeministrit (bashkëkryetar i KDP-së);

b) 1 përfaqësues i Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri (bashkëkryetar i KDP-së);

c) 1 përfaqësues i ADA-s;

d) 1 përfaqësues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit;

e) 1 përfaqësues nga shoqatat e qeverisjes vendore (me rotacion).

3. Aktorët e mëposhtëm do të kenë statusin e vëzhguesve në Komitet:

a) përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit, Ministria e Brendshme që mbulon vetëqeverisjen lokale; Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Shtetit për Sipërmarrje, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; aktorë të tjerë mund të ftohen nga bashkëkryetarët e KDP-së për t'iu bashkuar takimit si vëzhgues;

b) përfaqësues nga donatorë të tjerë të interesuar për këtë çështje (si për shembull, BE, KB);

c) përfaqësuesit e njësive të qeverisjes vendore të interesuara, shoqatat e saj dhe përfaqësuesit e qarqeve dhe shoqatat e tyre.

4. Vëzhguesit nuk kanë të drejtë të votojnë. Sipas nevojës dhe temës së diskutimit, aktorët e tjerë mund të ftohen të marrin pjesë si vëzhgues.

5. Sekretariati i Komitetit Drejtues të Projektit sigurohet nga Partneri Zbatues. Drejtuesi i Ekipit të Partnerit Zbatues merr pjesë në takim pa të drejtë vote.

6. KDP-ja mblidhet të paktën dy herë në vit.

7. KDP-ja do të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) të shqyrtojë dhe diskutojë progresin në lidhje me të gjitha aspektet e reformës së zhvillimit rajonal dhe të shkëmbejë informacionin mbi politikën;

b) të identifikojë, diskutojë dhe sugjerojë zgjidhje për problemet e mundshme të reformës së zhvillimit rajonal në Shqipëri dhe masat e nevojshme;

c) të mbështesë projektin dhe të japë udhëzime për gjetjen e zgjidhjeve ndaj problemeve të rëndësishme të zbatimit;

d) të zgjidhë mosmarrëveshjet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të projektit;

e) të shqyrtojë dhe atë provojë raportet 6-mujore dhe vjetore të progresit të projektit;

f) të sigurojë reagime për planin e aktiviteteve të paraqitura pranë Ambasadës së Zvicrës;

8. Takimet e paplanifikuara mund të thirren me kërkesë të një prej anëtarëve të Komitetit me të drejtë vote. Takimet njoftohen nga drejtuesit e Komitetit.

9. Për të siguruar cilësinë dhe shpërndarjen e produkteve, FSHZH-ja do të:

a) sigurojë kontroll periodik mbi produktet e ofruara nga Partneri Zbatues. Për të përmbushur këtë detyrë, Agjencia e Bashkëpunimit bie dakord me SDC-në dhe Partnerin Zbatues, lidhur me procedurën dhe afatet e paraqitjes së produktit, si dhe afatin e përcjelljes së komenteve dhe të sugjerimeve;

b) kryejë diskutime teknike për të gjitha çështjet e rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e projektit, ose ndikojnë në zbatimin e tij;

c) sigurojë komente dhe informacion teknik për rezultatet kryesore të projektit dhe, kur është e përshtatshme të kërkojë nga Partneri Zbatues për t'i rishikuar dhe për t'i përmirësuar ato;

d) t'i propozojë SDC-së miratimin e ndryshimeve dhe të shtesave në kushtet e projektit (planet e punës, ekspertizën etj.), në mbështetje të zbatimit dhe arritjes së objektivave të projektit.

Neni VII
Raportimi dhe informimi

Raportet e progresit përgatiten nga Partneri Zbatues çdo 6 muaj. Të dyja Palët do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo situatë që lind, e cila mund të ketë ndikim në zbatimin e Projektit.

Neni VIII
Monitorimi dhe vlerësimi

SDC-ja dhe Zyra e Zëvendëskryeministrit do të mbikëqyrin zbatimin e Projektit.

Neni IX
Prokurimi

SDC-ja do t'i akordojë zbatimin e projektit kompanisë Ecorys. Ecorys u zgjodh përmes një tenderi të hapur ndërkombëtar nga një komitet i përbashkët vlerësimi i SDC-së, ADA-s dhe qeverisë së Shqipërisë, në përputhje me rregullat zvicerane. Në parim, Partneri Zbatues është përgjegjës për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve ndërtimore të nevojshme për zbatimin e projektit, duke zbatuar parimet e konkurrencës së ndershme (të lirë dhe të barabartë) midis ofertuesve të mundshëm, në mënyrë që të arrihet rendiment në përdorimin e fondeve publike.

Partneri Zbatues duhet të nënkontraktojë vetëm në përputhje me rregullat zvicerane, siç përcaktohet në kontratën që do të lidhet ndërmjet tij dhe SDC-së. Në rastin kur Partneri Zbatues do të japë grante për institucionet shqiptare, të cilat nga ana e tyre prokurojnë mallra dhe shërbime, këto institucione do të lidhin çdo nënkontratë, në përputhje me rregullat shqiptare.

Neni X
Mallrat

1. Për kohëzgjatjen e Projektit, mallrat e siguruara me fonde nga SDC-ja, për t'u përdorur nga Projekti, do të mbeten në zotërimin e pakufizuar të Projektit dhe nuk do të dalin nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

2. Nëse, për ndonjë arsye, Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të siguruara me kontributin zviceran do të vendoset me shkrim nga Palët. Në një rast të tillë, SDC-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi në lidhje me mallrat në fjalë.

3. Në fund të Projektit, të dyja Palët do të bien dakord me shkrim për pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruara me fondet e Projektit.

Neni XI
Modifikimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim ose ndryshim i Marrëveshjes aktuale do të bëhet me shkrim, me pëlqimin e të dyja Palëve. Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose me zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me negociata diplomatike midis Palëve. Në këtë rast, teksti i përgjithshëm i Marrëveshjes mbizotëron mbi aneksin e saj.

Neni XII
Përfundimi i Marrëveshjes

1. Secila Palë do të ketë të drejtë të përfundojë këtë Marrëveshje duke dhënë një njoftim me shkrim për përfundimin e kontratës, gjashtë muaj përpara.

2. Nëse secila Palë pretendon se objektivat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të arrihen ose Pala e dytë nuk po përmbush detyrimet e saj, Pala tjetër do të ketë të drejtë të pezullojë ose të përfundojë

këtë Marrëveshje, duke dhënë një njoftim me shkrim tre muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, secila Palë mund të përfundojë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm, në rast të shkeljes së rëndë të Marrëveshjes. Shkelje e rëndë është shkelja serioze e objektivave thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje.

3. Nëse ngjarjet që vijnë nga forca madhore (fatkeqësi natyrore etj.) pengojnë ekzekutimin e Marrëveshjes, secila Palë mund të ndërpresë Marrëveshjen në fuqi që nga momenti kur bëhet e pamundur zbatimi i saj.

4. Në rast të përfundimit të parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje ose në fund të Projektit, çdo fond i pashpenzuar i siguruar në kuadër të Projektit do t'i kthehet SDC-së.

Neni XIII
Dispozita të përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk propozojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë përfitime të një natyre të çfarëdoshme. Ato nuk do të pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje e korruptuar ose e paligjshme përbën një shkelje të rëndë të kësaj Marrëveshjeje dhe justifikon përfundimin e saj, si dhe/ose të drejtën për marrjen e masave korrigjuese shtesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në ecurinë e Projektit dhe rezultatit të vlerësimit, Palët Kontraktuese do të vendosin nëse dhe në cilën formë të vazhdojnë bashkëpunimin përtej vitit 2023.

Neni XIV
Shtojcat

Përshkrimi i projektit (shtojca 1) përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Neni XV
Kohëzgjatja dhe efektiviteti

Kjo marrëveshje mbulon periudhën nga 1.4.2019 deri më 31.3.2023. Ajo hyn në fuqi pas përfundimit të procedurës ligjore të brendshme në Shqipëri dhe informimit të Palës zvicerane për hyrjen në fuqi, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe përfundon sapo të dyja Palët të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre kontraktuale.

Kjo marrëveshje është shkruar në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast të ndryshimeve në interpretim, ka përparësi versioni në gjuhën angleze.

Palët, nëpërmjet kësaj, konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të bërë në Tiranë më 30.4.2020

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Erion Braçe
Zëvendëskryeministër
Kryeministria

NË EMËR TË KONFEDERATËS ZVICERANE
Adrian Maître
Ambasador
Ambasada e Zvicrës

SHTOJCA 1
PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL FAZA 4 (PZHR 4)

1. Informacion i përgjithshëm

1.1 Informacion i përgjithshëm mbi situatën

Agjenda për integrimin evropian të Shqipërisë shoqërohet me një numër reformash, të cilat e përgatisin vendin për procesin e pranimit në BE. Kapitulli 22 i *Acquis communautaire* i BE-së për "politikën rajonale dhe bashkërendimin e instrumenteve strukturore" shërben si kuadri kryesor në të cilin Shqipëria përcakton këtë reformë.

Në Shqipëri, pushteti vendor është i organizuar në dy nivele: bashkitë (niveli i parë) dhe qarqet (niveli i dytë). Reforma Territoriale dhe Administrative më 2014, ajo më e rëndësishmja që prej vitit 1990, zvogëloi numrin e njësive të pushtetit vendor nga 373 në 61, duke synuar trajtimin e problemit të ndarjes së paefektshme dhe tejet të copëzuar territoriale dhe administrative të vendit. Për më tepër, reforma trajtoi zhvillimin asimetrik ekonomik të vendit, i cili gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit karakterizohej nga një lëvizje demografike drejt zonave të mëdha urbane.

Më 2015, qeveria e Shqipërisë i dha një shtysë të re reformës për Zhvillimin Rajonal (ZHR), duke e organizuar vendin sipas katër zonave rajonale të menaxhimit/rajoneve të zhvillimit. Si rrjedhojë, u krijuan strukturat e reja institucionale, të tilla si katër agjencitë për zhvillimin rajonal (AZHR), dhe u përgatitën projektpolitikat dhe ligjet. Në korrik të vitit 2018 Këshilli i Ministrave u shpreh se agjencitë rajonale të krijuara në vitin 2015 do të integrohen brenda strukturës së Fondit Shqiptar për Zhvillim (FSHZH), duke transferuar kështu të gjitha funksionet pranë FSHZH. Ky vendim prezantoi institucionet e reja dhe kërkon të bëhen përshtatjet e duhura të ligji për FSHZH-në, si dhe projektligji për ZHR-në.

2. Qëllimi, objektivat dhe rezultatet e pritshme

2.1 Qëllimi i përgjithshëm

Nxitja e një zhvillimi shoqëror dhe ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm duke u mbështetur në karakteristikat dhe atributet e rajoneve, duke ruajtur dhe zhvilluar karakteristikat e tyre natyrore dhe kulturore, duke inkurajuar potencialin e tyre të zhvillimit ekonomik me qëllim uljen e pabarazive në Shqipëri dhe sigurimin e kushteve më të mira sociale dhe ekonomike për qytetarët shqiptarë.

2.2 Objektivat specifikë

1. Mbështet orientimin e politikave qeveritare drejt një zhvillimi funksional rajonal, në përputhje me politikën rajonale të BE-së.

2. Hartimi dhe miratimi i një kornize strategjike dhe rregullatore që mundëson krijimin dhe funksionimin efikas të një sistemi të zhvillimit rajonal në përputhje me politikat dhe praktikat e BE-së.

3. Ngritja e një sistemi institucional të zhvillimit rajonal, si një mekanizëm efikas drejt administrimit dhe zhvillimit në nivel rajonal për menaxhimin e fondeve strukturore të BE-së në të ardhmen.

4. Bërja e administratës funksionale financiare dhe sistemit të administrimit të zhvillimit rajonal në nivelin qendror, rajonal dhe lokal, përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të skemave të granteve në kushte reale, duke ndikuar njëkohësisht në përmirësimin e jetës social-ekonomike të qytetarëve në Shqipëri.

2.3 Rezultatet për t'u arritur:

1. Plotësimi dhe përgatitja e kuadrit ligjor – ligjit për zhvillimin rajonal dhe kohezionin dhe akteve nënligjore.

2. Propozim për ngritjen e strukturave në nivel qendror dhe rajonal, përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e Politikës së Zhvillimit Rajonal.

3. Mbështetja e FSHZH-së si autoritet menaxhues dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për zhvillimin rajonal.

4. Përgatitja e kuadrit financiar shumëvjeçar për zhvillimin rajonal.

5. Ekspozim ndërkombëtar i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri.

6. Mbështetje për ngritje kapacitetesh kombëtare dhe rajonale në hartimin dhe komunikimin e një strategjie të duhur për implementimin e zhvillimit rajonal në nivel rajonal dhe lokal.

7. Zhvillimi i një mekanizmi të skemës së granteve, i cili mbështet përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të qytetarëve shqiptarë, duke reflektuar nevojat dhe prioritetet rajonale.

8. Forcimi i aftësive për të zhvilluar projekte në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

9. Forcimi i aftësive të menaxhimit të granteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

10. Vizibilitet dhe komunikim i skemave të granteve për Programin e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri.

3. Supozimet dhe risqet

3.1 Supozimet

1. Qeveria shqiptare implementon kuadrin ligjor për politikën e zhvillimit rajonal dhe prezanton të gjitha institucionet kompetente.

2. Qeveria shqiptare siguron qëndrueshmëri të kuadrit të procedurave institucionale për zhvillimin rajonal.

3. Ngritje e suksesshme e mekanizmit për implementimin e skemës së granteve.

4. Përfituesit kanë staf të mjaftueshëm.

5. Ngritja e sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të implementimit të Politikës.

6. Disponueshmëria e sistemit të duhur të IT-së.

7. Rajonet janë përcaktuar nëpërmjet një instrumenti ligjor të miratuar.

8. Ka një konsensus në dhënien përparësi të listës së projekteve.

3.2. Risqet

1. Ndryshimet strukturore në Palët e përfshira, të cilat nuk reflektojnë plotësisht zhvillimin rajonal.

2. Plane ambicioze për përgatitjen e programit operacional dhe implementimin e tij më 2020-ën.

3. Qeveria shqiptare mund të mos arrijë me sukses ngritjen e kuadrit ligjor për zhvillimin rajonal dhe prezantimin e institucioneve të përfshira.

4. Vonesa në përcaktimin e mekanizmit të partneritetit institucional për zhvillimin rajonal.

4. Qëllimi i punës

4.1 Kuadri strategjik i Projektit

Faza 4 e Projektit, është në linjë me parimin e qeverisjes së mirë të përmendur në Ligjin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Zvicrës, 2017–2020, me Strategjinë aktuale Zvicerane për Bashkëpunim me Shqipërinë, 2018–2021; ajo i referohet, veçanërisht, objektivit të parë të strategjisë për qeverisjen demokratike: "Institucione ekzekutive me arritje të lartë: Institucione ekzekutive nënkombëtare të përgjegjshme ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe efikase. Ajo, gjithashtu, përputhet edhe me Strategjinë Kombëtare Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim (SKSHZH) 2015–2020, e cila formulon objektivat strategjikë për zhvillimin rajonal, si edhe me Strategjinë Kombëtare për Decentralizimin dhe projektligjin për zhvillimin rajonal.

4.2 Përshkrimi i Projektit

Faza 4 e Projektit, të Zhvillimit Rajonal trajton tri nivele: në nivelin makro do të mbështetet zhvillimi dhe implementimi i politikës dhe ligjit kombëtar të ZHR-së; në nivelin e mesëm mbështetja do të sigurohet ndaj institucioneve kombëtare dhe rajonale, të cilat janë të ngarkuara me zhvillimin

dhe implementimin e Kuadrit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Programin Operativ për Zhvillimin Rajonal, përmes qasjes së partneritetit dhe në përputhje me vizionin për zhvillimin rural përmes iniciativës 100 fshatrat; në nivelin mikro mbështetja do të jepet për përgatitjen e procesit të zhvillimit të mekanizmit të grantit, i cili do të menaxhohet nga FSHZH-ja përmes financimit të projekteve për ZHR-në dhe përfshin dhe përgatit bashkitë dhe grupet e interesit vendor të përgatiten për aplikimin për grante dhe menaxhimin e tyre.

Ndërhyrja do të përqendrohet në dy qasje: Asistenca teknike dhe ndërtimi i kapaciteteve ndaj grupeve të ndryshme të interesit, në lidhje me ZHR-në dhe grantet për projektet e ZHR-së. Qasja e forcimit të sistemit zbatohet me idenë se i gjithë procesi testohet përmes sistemit – i shoqëruar nga projekti, duke siguruar ekspertizën e posaçme teknike dhe ndërtimin e kapaciteteve në punë.

Në bazë të tenderit publik të organizuar më 2016-ën, me praninë e qeverisë shqiptare, SDC-ja dhe ADA për fazën 3 dhe 4 të "Programit për Zhvillimin Rajonal", Ecorys fitoi mandatin për implementimin e PZHR-së në bashkëpunim me Co-Planin, organizatë e nënkontraktuar vendëse. Ecorys ka një përvojë të gjerë në mbështetjen e projekteve të zhvillimit rajonal në vende të tjera[1] dhe ekspertizë në vendin e origjinës në mbështetje të vendeve gjatë proceseve të pranimit në BE, e cila kombinohet me njohuritë e kontekstit vendës të partnerit shqiptar (përmes organizatës Co-Plan).

4.3 Përfituesit

Përfituesit e drejtpërdrejtë të ndërhyrjes janë qeveria e Shqipërisë, Fondi Shqiptar për Zhvillim (FSHZH) dhe katër njësitë rajonale të fondit të zhvillimit. Bashkitë do të jenë implementueset dhe përfitueset kryesore për investime dhe hartojnë programin, sipas një perspektive afatmesme. Përfituesit përfundimtarë janë shtetasit e Shqipërisë, të cilët do të përfitojnë nga politika të bashkërenduara më mirë dhe investime të qeverisë, duke marrë parasysh dallimet rajonale.

Shtetasit, gjithashtu, do të përfitojnë nga projektet e ZHR-së, të cilat synojnë të përmirësojnë drejtpërdrejt situatën socioekonomike të popullsisë.

4.4 Financimi

Për fazën 4 të Projektit do të sigurohet një shumë totale prej 6'000'000 franga zvicerane nga SDC-ja. ADA ka bashkëfinancuar projektin gjatë fazës së tretë dhe do të vazhdojë të bashkëfinancojë PZHR 4 me franga zvicerane 11725'000. Gjithashtu, do të përmbyllet edhe marrëveshja e deleguar e bashkëpunimit ndërmjet SDC-së dhe ADA-s.

4.5 Periudha kohore

Ndërhyrja e propozuar parashikon një fazë prej 48 muajsh nga 1.4.2019 deri më 31.3.2023; faza e daljes nga projekti do të vijojë për vitet 2023–2026, duke ndjekur, gjithashtu, edhe rekomandimet për shqyrtimin e projektit që do të kryhet më 2020-ën dhe progresin e Shqipërisë.

5. Monitorimi dhe vlerësimi

Kuadri logjik dhe planet e përvitshme të punës janë referimet kryesore për monitorimin e progresit dhe rezultateve gjatë implementimit të programit. Kuadri logjik do të përmbajë treguesit për çdo objektiv specifik dhe do të monitorohet nga brenda çdo 6 muaj. Ai, gjithashtu, do të shoqërohet nga standarde të mirëpërcaktuara dhe të rëna dakord, në bazë të planit të përbashkët të punës me homologun kombëtar, progresi i deritanishëm i reformës për ZHR-në dhe gjetjet dhe rezultatet e fazës III të programit. Shqyrtimi i përvitshëm i programit do të kryhet në bazë të raportit mbi shqyrtimin e përvitshëm. Ai do të vlerësojë ecurinë e programit të përgjithshëm dhe do të vlerësojë planin e përvitshëm të punës (PPP) për vitin e ardhshëm. Gjithashtu, do të kryhen dy vlerësime finale: shqyrtimi në mes të zbatimit të fazës dhe vlerësimi në fund të programit.

Do të krijohet Komisioni Drejtues i Programit i cili do të bashkëdrejtohet nga Zyra e Zëvendëskryeministrit dhe Ambasada Zvicerane dhe do të luajë rolin drejtues në përcaktimin e

[1] Mbështetja e mëparshme për zhvillimin rajonal dhe implementimin e politikës rajonale mbulon vende, si: Armenia, Gjeorgjia, Bjellorusia, Republika e Krimesë, Kazakistani, Serbia, Shqipëria dhe Kosova.

rreziqeve të mundshme dhe zhvillimin e strategjive për të zbutur efektet e dëmshme të shkaktuara prej tyre.